

Nr. Prot. 30480/2

Data 12.08.2022

Wz Prot 3182/2

12.08.2022

PROJEKT MARRËVESHJA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Sot, në datën 11.08.2022, palët e mëposhtme firmosin këtë Marrëveshje:

- **Banka OTP Albania SHA**, një shoqëri aksionere e themeluar dhe e organizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në regjistrin tregtar të Shqipërisë në datën 24.02.2004 me NUIS K41424801U dhe me seli në adresën Blv. Deshmoret e Kombit, Twin Towers, Kulla 1, Kati 9, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. **Bledar Shella**, i autorizuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme datë 05.08.2022.

(më poshtë referuar "OTP Albania" ose "Kompania Përthithëse")


- **BANKA ALPHA ALBANIA / ALPHA BANK ALBANIA SHA**, një shoqëri aksionere e themeluar dhe e organizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në regjistrin tregtar të Shqipërisë në datën 11.11.1997 me NUIS J72311006R dhe me seli në adresën Rruga e Kavajes, Qendra e Biznesit G-Kam, kati 2, Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Gabor Jandacsik i autorizuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme datë 11.08.2022.

(më poshtë referuar "AB Albania" ose "Kompania e Përthithur")

OTP Albania dhe AB Albania referohen më poshtë individualisht si "Pala" dhe së bashku "Palët" ose "Kompanitë subjekt i bashkimit".

MEQENËSE

- Në 6 Korrik 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë i dha OTP Bank Plc., një shoqëri e themeluar në Hungari me numër regjistrimi 01-10-041585 dhe selia e regjistruar e së cilës ndodhet në adresën 1051 Budapest, Nádor utca 16., Hungari ("OTP") miratimin paraprak për blerjen e 100% të aksioneve të AB Albania. Pas miratimit nga Banka e Shqipërisë dhe marrjes së lejes nga Autoriteti i Konkurrencës në 25 Mars 2022, 100% të aksioneve të AB Albania iu transferuan OTP ("Transferimi i Aksioneve"). Pas transferimit të aksioneve, OTP Albania dhe AB Albania tani janë 100% në pronësi të OTP Bank Plc. ("Aksioneri i vetëm").
- OTP, si aksionere e vetme e AB Albania dhe OTP Albania, vlerësoi paraprakisht mundësitë e ndryshme për racionalizimin e pranisë së saj në vend, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë aktuale dhe të ardhshme si dhe rentabilitetin e aktivitetit të biznesit të të dy subjekteve. Pas vlerësimit, OTP vendosi që të dyja kompanitë që janë subjekt i bashkimit të bashkohen. Rrjedhimisht, AB Albania (Kompania e Përthithur) do të bashkohet në OTP Albania (Kompania Përthithëse), dhe kjo e fundit do të jetë i vetmi subjekt juridik pas përfundimit të bashkimit ("Bashkimi").



- C. Pas vendimit të OTP-së, në të dyja Mbledhjet e Asambleve të Jashtëzakonshme të Aksionerëve (“Asambleja e Aksionarëve”) të OTP Albania që u zhvillua në 05.08.2022 dhe AB Albania që u zhvillua në 11.08.2022 është vendosur të vijohet me bashkimin dhe për këtë qëllim u vendos që AB Albania do të përthithet nga OTP Albania, sipas kushteve të përcaktuara këtu dhe në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë
- D. Kapitali i regjistruar i OTP Albania nuk do të zmadhohet pas bashkimit, prandaj kjo marrëveshje dhe ky bashkim nuk do të përfshijnë dispozita mbi raportin e këmbimit të aksioneve, shumën e çdo pagese në mjete monetare cash ose kushtet e ndarjes së aksioneve në Kompaninë Përthithëse.

PALËT NË KËTË PROJEKT MARRËVESHJE BIEN DAKORD SA MË POSHTË VIJON:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

- 1.1 Në këtë Marrëveshje (përfshirë deklarata dhe shtojcat) përveç rasteve kur konteksti e parashikon ndryshe ose përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në vijim, termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Marrëveshje”

është kjo Projekt Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje – duke përfshirë, si pjesë përbërëse të saj, deklaratat e mësipërme dhe shtojcat bashkëlidhur – të cilat janë nënshkruar dhe shkëmbyer nga dhe midis OTP Albania dhe AB Albania;

“Autoriteti”


është Banka e Shqipërisë dhe, vetëm nëse është relevante, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës dhe çdo gjykatë tjetër vendase ose e huaj, ose çdo autoritet tjetër gjyqësor, ose organ, departament, agjenci, komision, autoritet qeveritar, administrativ ose rregullator, organ, agjenci, komision, autoritet.

“Mbyllja”

është data në të cilën bashkimi bëhet efektiv ndërmjet OTP Albania dhe AB Albania në përputhje me nenin 6 dhe, në mënyrë të veçantë, nënshkrimi dhe shkëmbimi i të gjitha dokumenteve dhe zbatimi dhe përmbushja e të gjitha detyrimeve, të cilat duhet përkatësisht të nënshkruhen dhe shkëmbehen dhe të zbatohen në kuadrin e mbylljes për të mundur realizimin e bashkimit;

“Data e Mbylljes”

është data kur do të ndodhë Mbyllja, në përputhje me nenin 6;



“Ligji për Shoqëritë”	është ligji nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
“Deklarata e Mbylljes”	ka kuptimin që parashikohet në nenin 6.3
“Kodi i Punës”	është Ligji nr. 7961, datë 12/07/1995 “Mbi Kodin e Punës”, i ndryshuar;
“Bashkimi”	është Bashkimi me Përthithje i AB Albania (Kompania e Përthithur) nga OTP Albania (Kompania Përthithëse);
“Aktive dhe Detyrime të Transferuara”	janë të gjitha aktivet dhe detyrimet që transferohen nga AB Albania (Kompania e Përthithur) tek OTP Albania (Kompania Përthithëse) sikundër përshkruhet në këtë Marrëveshje.

1.2 Në këtë Marrëveshje:

- 1.2.1 Çdo ligj ose dispozitë ligjore i referohet ligjit ose dispozitës ligjore të ndryshuar, modifikuar ose ri-miratuar ose të dyja herë pas here (qoftë para ose pas datës së kësaj Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje) dhe çdo dispozitë tjetër nënligjore dalë në bazën e ligjit ose dispozitës ligjore (qoftë para ose pas datës së kësaj Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje).
- 1.2.2 Një klauzolë ose Shtojcë, përveç se kur parashikohet ndryshe nga konteksti, i referohet një klauzole ose shtojce të kësaj Marrëveshjeje.
- 1.2.3 Nëse nuk parashikohet ndryshe nga konteksti, numri njëjës do të përfshijë numrin shumë dhe anasjelltas.
- 1.2.3.1 Një gjini do të përfshijë gjininë tjetër.
 - 1.2.3.2 Ora e ditës është ora në Tiranë, Shqipëri.
 - 1.2.3.3 Titujt e kësaj Marrëveshje të Bashkimit nuk do të cenojnë interpretimin ose kuptimin.
 - 1.2.3.4 Shtojcat janë pjesë e kësaj Marrëveshje dhe rrjedhimisht janë efektive.

2. OBJEKTI I MARRËVESHJES: BASHKIMI ME PËRTHITHJE

- 2.1 Sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje, AB Albania do të bashkohet dhe do të përthithet nga OTP Albania.


- 2.2 Në zbatim të nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë, AB Albania do të transferojë nëpërmjet bashkimit tërësisht të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj dhe ekzistenca më vete e AB Albania do të përfundojë. OTP Albania do të jetë Shoqëria Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj nën emrin e regjistruar: "Banka OTP Albania" SHA.

3. EFEKTIVITETI KONTABËL

- 3.1 Tërësia e aktiveve dhe detyrimeve të AB Albania të cilat do të transferohen tek OTP Albania, do të bazohen në bilancin e audituar të AB Albania dhe OTP Albania më 31 dhjetor 2021, bashkëlidhur kësaj Marrëveshje [Shtojca 1] së bashku me pasqyrat financiare provizore më 30 qershor 2022 [Shtojca 2].
- 3.2 OTP Albania do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i parë pas bashkimit të OTP Albania do të paraqitet si rezultat i inkorporimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjendjes së pasqyrës së të ardhurave të AB Albania në OTP Albania duke filluar nga data 01.01.2022.

4. VIJUESHMËRIA DHE AKTIVET E TRANSFERUARA


- 4.1 Me fuqi në Datën e Mbylljes, OTP Albania do të jetë pasardhësja, nëpërmjet bashkimit me përthithje, e AB Albania në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat AB Albania është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh çdo ndryshim që ndodh deri në Datën e Mbylljes, të gjitha aktivet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivet materiale dhe jomateriale, të gjitha tepricat kreditore, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhënie të tjera juridike dhe pozicione juridike të çfarëdo lloji, të arkëtueshmet dhe detyrimet, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara të AB Albania, do të transferohen tek OTP Albania ("**Aktivet dhe Detyrimet e Transferuara**").
- 4.2 Aktivet dhe Detyrimet e Transferuara do të përfshijnë në mënyrë të veçantë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë vijon:
- (i) Çdo dhe të gjitha aktivet dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, aktive materiale dhe jomateriale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do t'i përkasin AB Albania;
 - (ii) Të gjitha markat tregtare, modelet e dizajnit, patentat, njohuritë, ekspertizën dhe të drejtat e tjera intelektuale të AB Albania ;
 - (iii) Licenca, koncesione, autorizime dhe të drejta të ngjashme të AB Albania;
 - (iv) Bazën e klientëve të AB Albania;
 - (v) Çdo kontratë qiraje, sigurimi, furnizimi, shitje, konsultimi, kontrata shërbimi dhe kontratat në të cilat AB Albania është palë, qoftë të lidhura tashmë ose që janë aktualisht në proces negociimi;



- (vi) Çdo kredi, borxh, depozitë të çdo lloji të krijuar nga AB Albania;
 - (vii) Çdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen më ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura ndaj AB Albania;
 - (viii) Çdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt çdo Autoriteti ku AB Albania është palë;
 - (ix) Çdo dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i atribuohen AB Albania, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet tatimore, potenciale dhe ardhshme të AB Albania të cilat rezultojnë nga një akt ose veprim që ka ndodhur tashmë;
- 4.3 Nëse pëlqimi i një kreditori ose i një pale të tretë është i nevojshëm për transferimin e aktiveve të caktuara, AB Albania dhe OTP Albania do të përpiqen ta sigurojnë atë;
- 4.4 OTP Albania do të marrë në zotërim të gjitha librat, korrespondencën, të dhëna operative dhe të dhëna të tjera të biznesit që ruan dhe mban AB Albania. OTP Albania gjithashtu do të marrë në zotërim çdo dhe të gjitha instrumentet dhe dokumentet e nevojshme për të paraqitur të drejtat që i janë transferuar asaj. OTP Albania do të ruajë librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit të AB Albania përgjatë periudhës ligjore të ruajtjes.
- 4.5 Të gjitha regjistrimet, shënimet, titujt dhe/ose shënimet në lidhje me AB Albania në Zyrën e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme, Regjistrin e Barrës Siguruese, ose ndonjë regjistër tjetër që mbahet nga çdo Autoritet do t'i transferohen OTP Albania në Datën e Mbylljes nëpërmjet bashkimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. OTP Albania do të jetë pasuesi i AB Albania në çdo dhe të gjitha të drejtat, kompetencat dhe marrëdhëniet që kanë të bëjnë me AB Albania dhe që rrjedhin nga dispozitat e akteve ligjore dhe/ose nënligjore. Çdo dhe të gjitha barrët, kolaterale ekzistuese dhe/ose garancitë e krijuara në favor të AB Albania do të vazhdojnë të jenë të vlefshme, në favor të OTP Albania si pasardhëse e AB Albania dhe të zbatueshme sipas klasifikimit të tyre.

5. KUSHTET PËR REALIZIMIN E MBYLLJES

- 5.1 Përfundimi i transaksionit të Bashkimit të parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshje është subjekt dhe kushtëzohet nga plotësimi dhe përmbushja e kushteve të mëposhtme përpara Mbylljes:
- (i) Vendimi i Asamblesë së Aksionarëve të AB Albania dhe OTP Albania për përfundimin e Bashkimit duhet të jetë miratuar të paktën një muaj pas datës së publikimit të kësaj Marrëveshje në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 216.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
 - (ii) Dhënia e miratimit ose konfirmimit të bashkimit nga të gjitha Autoritetet në Shqipëri dhe realizimi i të gjitha njoftimeve të nevojshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, dukë përfshirë por pa u kufizuar në miratimin nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri.



6. MBYLLJA


- 6.1 Mbyllja do të bëhet në drejtorinë qendrore të OTP Albania në Tiranë sa më shpejt që të jetë e mundur, pas përmbushjes së kushteve paraprake për Mbylljen, ose në çdo datë tjetër ose në çdo vend tjetër ku palët do të dakordësojnë në mënyrë reciproke.
- 6.2 Në ose përpara datës së Mbylljes, Palët do të realizojnë nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të mëposhtme:
- (i) Dorëzimin e vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve të OTP Albania dhe AB Albania ku miratohet Mbyllja e Transaksionit të Bashkimit, marrëveshjen përfundimtare të bashkimit, dhe dokumentet përkatëse dhe/ose çdo dokument tjetër kushtëzues, nëse ka;
 - (ii) Shkresat e dorëheqjes dhe/ose revokimit të administratorit(ëve) të deleguar dhe/ose anëtarëve të organeve drejtuese/përfaqësuese të AB Albania.
- 6.3 Pas nënshkrimit dhe/ose dorëzimit të dokumenteve të parashikuara në nenin 6.2 më sipër, Palët do të nënshkruajnë Deklaratën e Mbylljes [Shtojca 3] e cila dëshmon përmbushjen e çdo dhe të gjitha kushteve dhe detyrimeve të Palëve për efektivitetin e Bashkimit.
- 6.4 Bashkimi do të bëhet efektiv në datën e regjistrimit të Bashkimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë ("Data e Mbylljes").

7. SHOQËRIA; TË DREJTAT DHE PËRFITIMET E VEÇANTA

- 7.1 Statuti ekzistues i OTP Albania, i ndryshuar, nëse është e nevojshme dhe i miratuar rregullisht, do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.
- 7.2 Anëtarët e organeve të shoqërisë të OTP Albania në Datën e Mbylljes do të jenë anëtarë të organeve të Shoqërisë Përthithëse. Administratori dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese/të përfqësimit/mbikëqyrëse të AB Albania do të japin dorëheqjen dhe/ose do të revokohen në Datën e Mbylljes.
- 7.3 Nuk ekziston asnjë titullar i obligacioneve të konvertueshme dhe aksioneve preferenciale që preket nga Bashkimi. Nuk jepet asnjë e drejtë e posaçme. Aksionari i vetëm i OTP Albania do të vijojë të gëzojë të njëjta të drejta edhe pas Bashkimit.

8. MBROJTJA E KREDITORIT

- 8.1 Kreditorët e AB Albania janë të mbrojtur në zbatim të nenit 221 të Ligjit për Shoqëritë.



9. PASOJAT PËR PUNONJËSIT

- 9.1 Pasojat e Bashkimit për punonjësit e AB Albania do të burojnë në bazë të neneve 138, 139 dhe 139/1 të Kodit të Punës.
- 9.2 Në Datën e Mbylljes, të gjitha kontratat e punës ku AB Albania është pjesëmarrësi si palë në atë kohë, do t'i transferohen në bazë të ligjit OTP Albania, e cila do të vazhdojë kontratat e punës të punonjësve të transferuar së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.
- 9.3 Kontratat kolektive të AB Albania, nëse ka, do të zëvendësohen nga kontrata kolektive të OTP Albania.
- 9.4 OTP Albania do të jetë përgjegjëse për çdo dhe të gjitha detyrimet, përfshirë detyrimet e papaguara që burojnë nga kontratat e transferuara të punës.

10. PËRFUNDIMI I KONTRATËS

- 10.1 Kjo Marrëveshje do të përfundojë vetëm në bazë të miratimit me shkrim të të dyja palëve përpara Datës së Mbylljes.



11. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- 11.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje me ligjet dhe çdo dokument tjetër që ka forcën e ligjit në Republikën e Shqipërisë.
- 11.2 Juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit të Tiranës.

12. TË NDRYSHME

- 12.1 Depozitimi

Palët bien dakord që OTP Albania dhe AB Albania do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme brenda kompetencave të tyre që duhen për të siguruar dhe garantuar përmbushjen e kushteve të parashtruara në nenin 5.1 (ii) më sipër. Për këtë qëllim, Palët, qoftë bashkërisht ose individualisht sipas rastit, duhet të paraqesë pranë çdo Autoriteti kompetent – duke përfshirë, për të shmangur çdo dyshim, Bankën e Shqipërisë – çdo kërkesë të miratimit ose njoftimit të nevojshëm për të bërë Bashkimin sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje. Pala përkatëse merr përsipër të paraqesë të gjithë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar për këtë qëllim. Për të shmangur çdo dyshim paraqitja e kërkesës në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të bëhet respektivisht nga AB Albania dhe OTP Albania.

  7

12.2 Kostot

OTP Albania do të paguajë kostot në lidhje me Bashkimin dhe në veçanti kostot që lidhen me Mbylljen dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit ligjërish të detyrueshëm.

12.3 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje (së bashku me të gjitha dokumentet e përmendura në të, ose të nënshkruara në datën e Mbylljes ose përpara saj) përbën tërësinë e Marrëveshjes dhe dakordësinë midis Palëve në lidhje me përmbajtjen saj dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, kontratat ose sipërmarrjet e mëparshme lidhur me këtë çështje.

12.4 Amendimi

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë efektiv nëse nuk është bërë me shkrim nga Palët.

12.5 Pavlefshmëria e pjeshme

Nëse një pjesë e kësaj Marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme ose jo e detyrueshme për zbatim, Palët janë të detyruara të respektojnë pjesën e mbetur. Palët në këtë rast do të zëvendësojnë pjesën e pavlefshme ose të jo të detyrueshme për zbatim me dispozita të cilat janë të vlefshme dhe të detyrueshme dhe efekti i të cilave, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, është në masën më të madhe të mundshme, e njëjtë me pjesën e pavlefshme ose jo të detyrueshme për zbatim.

12.6 Njoftimi

Përveç se kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, të gjitha komunikimet do të jenë me shkrim dhe do të dërgohen me telegram, fax ose telex me marrje konfirmimi drejtuar si më poshtë vijon::

(a) OTP Albania

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kulla 1, kt.9 Tiranë

Në vëmendje të: Z. Bledar Shella, Drejtor i Përgjithshëm


(b) AB Albania

Adresa: Rruga e Kavajes, Qëdra e Biznesit, G-Kam, kt. 4

Në vëmendje të: Z. Gabor Jandacsik, Drejtori i Përgjithshëm

12.7 Gjuha

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast në ndonjë mospërputhje midis versioneve, versioni anglisht do të mbizotërojë.



[FAQJA E NENSHKRIMEVE VIJON]

Banka OTP Albania SHA

Përfaqësuar nga:

Z. Bledar Shella

Nënshkrimi: Bledar Shella



BANKA ALPHA ALBANIA / ALPHA BANK ALBANIA SHA

Përfaqësuar nga:

ALPHA BANK ALBANIA SHA


Z. Gabor Jandacsik

Nënshkrimi: GABOR JANDACSIK

SHTOJCA 1: PAQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA TË OTP ALBANIA DHE AB ALBANIA MË 31
DHJETOR 2021

SHTOJCA 2: PASQYRAT FINANCIARE MË 30 QERSOR 2022

SHTOJCA 3: FORMË STANDARDE E DEKLARATËS SË MBYLLJES



Nr. Prot. 30480
Datë 12.08.2022

Wc Prot 3182
12.08.2022

RAPORTI I BASHKIMIT

LËNDA:

I/ HYRJE.....	1
II/ MËNYRA E RIORGANIZIMIT.....	1
III/ PROJEKT-MARRËVESHJA E BASHKIMIT.....	2
IV/ PASOJAT MBI PUNONJËSIT.....	3

I/ HYRJE

OTP Bank Plc. ("OTP" ose "OTP Bank", dhe së bashku me filialet "Grupi OTP" ose "Grupi") – është një prej aktorëve kryesorë në rajon. Bazuar në aspektet ekonomike dhe ligjore Grupi OTP ofron shërbimet e tij financiare universale nëpërmjet disa filialeve në 11 vende.

Grupi OTP është prezent në Shqipëri që prej vitit 2019, përmes filialit OTP Bank Albania sh.a dhe aktualisht ka zgjeruar prezencën e tij përmes blerjes së 100% të aksioneve të Banka Alpha Albania sh.a.

Në datën 6 Dhjetor 2021, OTP Bank nënshkroi marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve me Alpha International Holdings Single Member S.A., për blerjen e 100% të aksioneve të filialit shqiptar të bankës greke Alpha Bank SH.A. Transaksioni u autorizua paraprakisht nga Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr. 187 datë 25.3.2022 dhe u aprovua nga Banka e Shqipërisë me vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr. Nr.31 datë 06.07.2022.

Banka OTP Albania sha, ka selinë e saj qendrore në Tiranë, Shqipëri; është themeluar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 30724, datë 12.12.2003, pajisur me numër NIPT K41424801U dhe ushtron aktivitetet bankar dhe financiar bazuar në Liçencën e Bankës së Shqipërisë nr. 17 datë 16.2.2004.

Banka Alpha Albania sh.a, ka selinë e saj qendrore në Tiranë, Shqipëri; është themeluar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 12825, datë 16.11.1997, pajisur me NIPT J72311006R dhe ushtron aktivitet bankar dhe financiar bazuar në Liçencën e Bankës së Shqipërisë Nr. 11 datë 7.1.1998.

Të dy Bankat zotërohen aktualisht 100% nga OTP Bank Plc. Strategjia kryesore e aksionarit të vetëm për Shqipërinë gjatë vitit 2022-2023 është të realizojë një proces bashkimi të shpejtë dhe sa më të lehtë të filialeve Banka Alpha Albania sh.a ("ABA") dhe Banka OTP Albania sh.a ("OBA"). Transaksioni i bashkimit është subjekt miratimi nga Autoriteti Mbikqyrës dhe procesi do të drejtohet me synimin për të arritur realizimin e bashkimit të bankave në fund të Nentorit 2022.

II/ MËNYRA E RIORGANIZIMIT

OTP Bank Plc. ka vendosur të iniciojë procesin e riorganizimit të Bankave përmes bashkimit me përthithje të filialeve të saj në Shqipëri. Lloji i bashkimit i përzgjedhur nga Komiteti Operativ është bashkimi me përthithje sipas nenit 216 e në vazhdim të Ligjit Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe neni 20 i

Rregullores së Bankës së Shqipërisë 14/2009 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë".

Komiteti operativ i projektit të bashkimit ka vendosur që pasardhësi ligjor do të jetë Banka OTP Albania sha bazuar në argumentat e mëposhtëm:

- ✓ OBA është një Bankë më e madhe dhe më e përshtatshme të pranojë data bazën e klientëve, asetëve dhe detyrimeve të bankës së përthithur;
- ✓ OBA është një filial i integruar tashmë me rregulloret dhe procedurat e grupit OTP;
- ✓ OBA ka një infrastrukturë lokale të platformës SWIFT dhe një listë bankash korrespondente tashmë të validuara nga Grupi OTP;
- ✓ Skenari i bashkimit me përthithje ku OBA është banka përthithëse është më i preferueshëm nga pikëpamja fiskale.

Përsa më sipër, bashkimi do të realizohet nga Banka OTP Albania sh.a e cila do të përthihë tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të Bankës Alpha Albania sh.a Kapitali nuk do të zmadhohet si rezultat i bashkimit me përthithje. Kapitali i regjistruar i Bankës Alpha Albania sh.a pasi të netohet me zëra të tjera të kapitalit neto të bilancit të Bankës Alpha Albania sha do të transferohet në kapitalin neto të Bankes OTP Albania sh.a, si rezerve e veçantë.

Duke qënë se kapitali nuk do të zmadhohet pas bashkimit me përthithje, dokumentat e bashkimit nuk do të rregullojnë çështje të tilla si raportin e këmbimit të aksioneve, apo çdo shumë të pagueshme në para apo forma të tjera të këmbimit të aksioneve në Bankën OTP Albania sh.a nuk

III/ PROJEKT-MARRËVESHJA E BASHKIMIT

Projekt marrëveshja e bashkimit është subjekt miratimi nga asambltetë e aksionerëve të shoqërive të përfshira në bashkim, OBA dhe ABA.

Bazuar në termat dhe kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit ABA do të përthithet nga Banka OTP Albania sh.a

Në zbatim të nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë tregtare, AB Albania do të transferojë nëpërmjet bashkimit tërësisht të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj dhe ekzistenca më vete e AB Albania do të përfundojë. OTP Albania do të jetë Shoqëria Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj nën emrin e regjistruar: "Banka OTP Albania" SHA.

Statuti ekzistues i OTP Albania, i ndryshuar, nëse është e nevojshme dhe i miratuar rregullisht, do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Anëtarët e organeve drejtuese të Bankës OTP Albania në datën e përfundimit të transaksionit do të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Bankës përthithëse.

OTP Albania do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i parë pas bashkimit të OTP Albania do të paraqitet si rezultat i inkorporimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjendjes së pasqyrës së të ardhurave të AB Albania në OTP Albania duke filluar nga data 01.01.2022.

IV/ PASOJAT MBI PUNONJËSIT

Pasojat e Bashkimit për punonjësit e AB Albania do të burojnë në bazë të neneve 138, 139 dhe 139/1 të Kodit të Punës.

Në Datën e Mbylljes, të gjitha kontratat e punës ku AB Albania është pjesëmarrësi si palë në atë kohë, do t'i transferohen në bazë të ligjit OTP Albania, e cila do të vazhdojë kontratat e punës të punonjësve të transferuar së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Kontratat kolektive të AB Albania, nëse ka, do të zëvendësohen nga kontrata kolektive të OTP Albania.

OTP Albania do të jetë përgjegjëse për çdo dhe të gjitha detyrimet, përfshirë detyrimet e papaguara që burojnë nga kontratat e transferuara të punës.

Ky raport hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe në rast mospërputhjes mes të dy versioneve, versioni shqip prevalon.

Nënshkruar, në Tiranë, më **11.08.2022**, mes :

Banka OTP Albania sh.a

Përfaqësuar nga:

Mr. Bledar SHELLA



Drejtor i Përgjithshëm




Banka Alpha Albania sh.a

Përfaqësuar nga:

Mr. Gabor JANDACSIK

ALPHA BANK ALBANIA SHA



Drejtor i Përgjithshëm

Raporti i Ekspertit Mbi Bashkimin Me Përthithje Të
Bankës OTP Albania sha me Alpha Bank Albania sha

Përmbajtja

	Faqe
Raporti mbi bashkimin me përthithje të Bankës OTP Albania sha me Bankën Alpha Albania sha	
Raporti i Ekspertit Kontabël	i-ii
Informacion i përgjithshëm	2
Blerja e Alpha Bank	3
Vendimi për bashkimin me përthithje	3
Politikat bazë kontabël	4
Informacionet financiare	6

Raporti i Ekspertit Kontabël

Të nderuar,

Kemi kënaqësinë të paraqesim raportin tonë, në formë të shkruar, sipas kontratës së datës 07 korrik 2022 (“Kontrata”).

Qëllimi i angazhimit dhe kufizimet

Në përputhje me Kontratën për të ofruar shërbime profesionale, datë 07 korrik 2022, Grant Thornton shpk u angazhua nga Banka OTP Albania sh.a për përgatitjen e raportit të ekspertit kontabël mbi bashkimin me përthithje të Alpha Bank Albania sha (shoqëri e përthitur) me Banka OTP Albania sha (shoqëri përthithëse) në përputhje me rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”.

Procedurat e kryera nga ne për hartimin e raportit të ekspertit kontabël përfshijnë intervista me drejtimin, procedura analitike, rakordime të informacionit financiar të dy entiteteve të lartpërmendura dhe analiza të informacionit ligjor të vënë në dispozicion si vendimarrje të aksionarëve dhe strukturave drejtuese, marrëveshje shitblerje aksionesh, raporti i audituesit të pavarur, ekstrakte QKB, rregullore të mbikëqyrjes bankare, kuptueshmëri të zbatimit të politikave kontabël kryesore në hartimin e pasqyrave për qëllime financiare, MRF, etj.

Në përputhje me angazhimin sipas Kontratës, opinionet tona në këtë Raport bazohen në informacionin dhe shpjegimet e siguruara nga Drejtimi i Bankës OTP Albania Sha. Analiza e të dhënave të Drejtimit nga ana e Grant Thornton nuk përbën auditim në përputhje me Standartet e Auditimit.

Qëllimi i këtij raporti është për plotësuar kërkesat ligjore të rregullores për “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, pika 2.c.

Konkluzioni

Bazuar në procedurat e kryera nga ne, nuk na ka tërhequr vëmendjen asgjë, që na bën të besojmë se Pasqyra e Pozicionit Financiar për qëllime të veçanta e datës 30 qershor 2022 dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital për qëllime të veçanta për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022 të përgatitura në të gjitha aspektet materiale në përputhje me “Metodologjinë e Raportimit Financiar (MRF)”, sipas raportit të ekspertit të pavarur Ernst and Young Albania të datës 17.08.2022, reflektojnë në mënyrë të sigurtë efektet e Marrëveshjes së Bashkimit.

Gjithashtu, sipas opinionit tonë qasja e propozuar nga drejtimi i bankave të bashkuara është e përshtatshme duke marrë në konsideratë se ky bashkim nuk do të përfshijë raportin e këmbimit të aksioneve, por do të synojë transferimin e të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur në kapital në një llogari specifike “Rezervë nga bashkimi”.

Kufizime

Në përputhje me Kontratën, ky Raport është i kufizuar vetëm në shërbimet e rëna dakord. Ky Raport nuk merr në konsideratë dhe nuk jep konkluzione në lidhje me çështjet tatimore. Në lidhje me çështje të rëndësishme tatimore, ky Raport nuk është shkruar dhe nuk mund të përdoret nga askush për qëllim të shmangies të penaltiteteve tatimore.

Burimet e informacionit

Ky raport është i datës 17 gusht 2022 dhe përmban informacionin financiar dhe jo financiar të siguruar nga Drejtimi deri në këtë datë.

Informacioni i përfshirë në këtë Raport është bazuar kryesisht në burimet e mëposhtme:

- Pasqyrat financiare të Bankës OTP Albania Sha;
- Pasqyrat financiare të Bankës ALPHA BANK ALBANIA Sha;
- Pasqyrat e audituara financiare mbi bashkimin me përthithje të bankave më 30.06.2022;
- Vendimet e asamblesë së aksionerit mbi bashkimin me përthithje;
- Informacione të publikuara.

Formati i raportit

Për lehtësinë tuaj, ky Raport vendoset në dispozicion për ju në format elektronik, si dhe në kopje fizike. Kopjet e shumëfishta dhe versionet e këtij Raporti mund të ekzistojnë në media të ndryshme. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, kopja e nënshkruar duhet të konsiderohet si përfundimtare.

Konfidencialiteti

Ky Raport është konfidencial dhe është përgatitur në mënyrë eksklusive për Bankën OTP Albania Sha dhe Bankën e Shqipërisë. Raporti nuk duhet të përdoret, riprodhohet ose qarkullohet për qëllime të tjera, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, pa aprovimin fillestar me shkrim të Grant Thornton. Ne nuk marrim përgjegjësi për punën tonë nga palë të tjera, përveç Klientit dhe Bankës së Shqipërisë. Ne nuk marrim përgjegjësi për dëmtime ose humbje potenciale të Klientit.

Të përgjithshme

Ky Raport është lëshuar mbi supozimin që Drejtimi ka siguruar të gjithë informacionin që mund të ketë impakt në Raport deri në datën e Raportit. Gjithashtu, ne nuk kemi përgjegjësi për ngjarje ose rrethana që mund të materializohen pas datës së Raportit dhe që mund të ndryshojnë rezultatet e tij.

Me respekt,

Grant Thornton shpk



Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
18.08.2022



Njoftim i rëndësishëm

Grant Thornton shpk (“Grant Thornton” ose “Eksperti Kontabël”) është angazhuar nga Banka OTP Albania Sha (“Klienti” ose “Shoqëria”) për përgatitjen e raportit të ekspertit kontabël mbi bashkimin me përthithje të Bankës ALPHA BANK ALBANIA Sha nga Banka OTP Albania Sha në përputhje me rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, pika 2.c.

Në mënyrë të veçantë, Grant Thornton nuk ka përgjegjësi apo detyrim ndaj palëve të tjera të ndryshme nga Klienti dhe palëve të tjera që mbështeten në këtë Raport, sic paraqitet në Kontratë, në lidhje me, ose si rezultat i këtij dokumenti apo me përmbajtjen e tij. Palët e tjera, të cilat nuk janë të përmendura në Kontratë dhe që mbështeten në këtë Raport, në mënyrë të pjesshme apo të plotë, e bëjnë këtë gjë në riskun e tyre.

Qëllimi dhe natyra e punës që është kryer nga Grant Thornton, për këtë dokument, kufizohet siç paraqitet në hyrje të këtij Raporti. Gjatë kryerjes së këtyre shërbimeve dhe pas paraqitjes së këtij dokumenti, Grant Thornton nuk mban përgjegjësi për vendimarrjen e Klientit në lidhje me ndjekjen ose jo të strategjive ose veprimeve të caktuara.

Gjatë punës tonë, ne përdorëm informacionin financiar dhe jo financiar të siguruar nga Menaxhimi, gjithashtu edhe informacionin publik. Informacioni i marrë i përket periudhës deri në datën e Raportit dhe është siguruar nga Drejtimi gjatë intervistave tona. Ne nuk kemi verifikuar informacionin e marrë nga burimet e përmendura dhe për rrjedhojë nuk mund mbajmë përgjegjësi për saktësinë e tij, por ne e konsiderojmë informacionin e siguruar si të arsyeshëm. Gjetjet tona ndikohen nga ky informacion, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i saktë në të gjitha aspektet materiale. Ne nuk kemi audituar informacionin e marrë dhe për rrjedhojë nuk shprehim opinion auditimi me anë të këtij Raporti.

Ky raport është konfidencial dhe është përgatitur ekskluzivisht për drejtuesit e Klientit dhe Bankën e Shqipërisë dhe nuk duhet të përdoret, riprodhohet ose qarkullojë për qëllime të tjera, terësisht ose pjesërisht, pa miratimin paraprak me shkrim nga Grant Thornton shpk.

1. Informacion i përgjithshëm

OTP Bank Plc. ("Banka") është një shoqëri e themeluar në 1949 dhe e regjistruar në Hungari me numër regjistrimi 01-01-041585 dhe seli në 1051 Budapest, Nádor utca 16., Hungari. OTP Bank Group është një nga ofruesit më të mëdhenj të pavarur të shërbimeve financiare në Evropën Qendrore dhe Lindore me një gamë të plotë shërbimesh bankare për individë dhe shoqëri. OTP Group përbëhet nga filiale të mëdha që ofrojnë shërbime në fushën e sigurimeve, pasurive të paluajtshme, faktoringut, leasing-ut dhe menaxhimit të aseteve, investimeve dhe fondeve të pensione. Banka u shërben klientëve në 10 vende, përkatësisht në Hungari, Bullgari, Serbi, Rumani, Kroaci, Ukrainë, Mal të Zi, Slloveni, Shqipëri dhe Rusi.

OTP Bank Plc është aksionari i vetëm i OTP Bank Albania Sh.a ("OTP") një institucion financiar shqiptar i krijuar sipas ligjit shqiptar mbi shoqëritë tregtare dhe i licensuar nga Banka e Shqipërisë ("Banka Qendrore") më 16 shkurt 2004 (vendimi nr. 17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr. 8365 "Mbi sistemin bankar në Shqipëri" i muajit korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269 i dhjetorit 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë". Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. Bazuar në marrëveshjen e blerjes së aksioneve të datës 28 mars 2019, OTP Bank NYRT, me seli qendrore në Budapest, Hungari, bleu 100% të aksioneve të Societe Generale Albania sh.a nga aksioneri i mëparshëm Societe Generale Group me vendndodhje në Francë.

Më 30 qershor 2022, Banka ka operuar përmes zyrave qendrore që ndodhen në Tiranë dhe 39 degëve të saj (2021: 39 degë). Banka ushtron aktivitet vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 30 qershor 2022 Banka kishte 501 punonjës (31 dhjetor 2021: 475 punonjës). Zyra e regjistruar e Bankës është pranë Twin Towers, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla 1, Kati 9, Tiranë, Shqipëri.

Alpha International Holdings Single Member S.A, një shoqëri e regjistruar sipas ligjeve të Greqisë, me numër regjistrimi 155249901000 dhe me seli në Athinë, Attica, 77 Bulevardi Athinon, Greqi është aksionari i vetëm i Bankës Alpha Albania sha ("ABA"), një shoqëri aksionare dhe institucion bankar i licensuar, i regjistruar dhe që ekziston sipas ligjeve të Shqipërisë me numër unik identifikimi të subjektit J72311006R dhe seli në Rruga e Kavajës, Qendra e Biznesit G-KAM, Kati 2-të, Tiranë, Shqipëri.

Më 29 shkurt 2012 Banka u shndërrua në filial në bazë të Vendimit nr. 14 të Bankës së Shqipërisë dhe është licensuar në datën 17 maj 2012 për kryerjen e transfertave të pagesave, aktiviteteve të kredisë dhe depozitave, si dhe veprimtari të tjera sipas ligjit për bankat (nr. 8365, datë 2. korrik 1998, i ndryshuar më 18 dhjetor 2006) dhe Ligjit për Bankën e Shqipërisë (nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997) dhe ndryshoi emrin në Alpha Bank Albania SHA.

Kompania Mëmë e bankës është Alpha International Holdings Single Member SA. Kompania mëmë kontrolluese përfundimtare e bankës është Alpha Bank S.A.

Më datë 16 prill 2021 u krye shitja e 100 % të aksioneve nga aksionari i Alpha Bank në favor të Alpha International Holdings Single Members S.A. Me vendimin e shoqërisë Alpha International Holdings Single Member S.A., datë 18 janar 2021 u vendos blerja e aksioneve të Alpha Bank sha dhe regjistrimi i Shoqërisë në organet kompetente në Shqipëri. Banka e Shqipërisë me vendimin nr. 3, datë 13.01.2021 vendosi miratimin paraprak për zotërimin 100 % të aksioneve të Alpha Bank Albania sha nga Alpha International Holdings Single Member S.A.

Më 31 dhjetor 2021 Banka ka 34 degë në të gjithë vendin (2020: 34 degë), nga të cilat 12 ndodhen në Tiranë (2020:12 degë).

2. Blerja e Alpha Bank

Bazuar në Marrëveshjen e Transferimit Lokal, më 6 dhjetor 2021, OTP Bank Plc. ("Blerësi") nënshkroi një marrëveshje shitblerjeje aksionesh me Alpha International Holdings Single Member S.A. ("Shitësi"), sipas së cilës Shitësi ka vendosur të shesë dhe Blerësi ka vendosur të blejë 100% të aksioneve sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen e Shitblerjes së Aksioneve. Sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, Shitësi shet dhe Blerësi blen me garanci të plotë të titullit dhe të lira nga çdo barrë, aksionet dhe të gjitha të drejtat lidhur me aksionet në mbyllje. Blerja u finalizua me 18 korrik 2022 pas marrjes së miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë me Vendimin Nr. 31, datë 06 korrik 2022.

3. Vendimi për bashkimin me përthithje

Motivi i bashkimit me përthithje të shoqërive është grupimi i forcave dhe mjeteve për "Përmirësimin e shërbimeve financiare nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, si dhe zgjerimin e aktivitetit në shkallë kombëtare". OTP Bank vlerësoi paraprakisht mundësinë e racionalizimit të saj në vend, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë aktuale dhe në të ardhmen, natyrën e biznesit, si dhe rentabilitetin e aktivitetit të biznesit të Palëve.

Banka Alpha Bank Albania sha ("Shoqëria e përthitur") do të bashkohet me Bankën OTP Albania Bank sha ("Shoqëria Përthithëse") dhe kjo e fundit do të jetë i vetmi subjekt juridik pas përfundimit të bashkimit.

Shoqëria e përthitur dhe Shoqëria përthithëse kanë qëllim të realizojnë bashkimin në përputhje dhe bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.01.2008, i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimin nr. 14, datë 11.3.2009 për miratimin e rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë". Draft marrëveshja e bashkimit daton më 12 gusht 2022.

Asambleja e përgjithshme e Bankës OTP Albania sha më datë 5 gusht 2022 vendosi:

- (i) Fillimin e procedurës së bashkimit më përthithje të OTP Bank Albania sha (shoqëria përthithëse) me Alpha Bank Albania sha (shoqëria e përthitur);
- (ii) Kapitali i regjistruar i Bankës OTP Albania sha mos të rritet si pasojë e bashkimit;
- (iii) Aprovimi i raportit paraprak të bashkimit;
- (iv) Aprovimi i planit të biznesit;
- (v) Aprovimi i marrëveshjes paraprake të bashkimit;
- (vi) Caktimi i ekspertit të pavarur për ekzaminimin e bashkimit dhe përgatitjen e raportit të tij.

Asambleja e aksionarëve të Bankës ALPHA BANK Sha e mbledhur më datë 11 gusht 2022 vendosi:

- (i) Fillimin e procedurës së bashkimit më përthithje të OTP Bank Albania sha (shoqëria përthithëse) me Alpha Bank Albania sha (shoqëria e përthitur);
- (ii) Kapitali i regjistruar i Bankës OTP Albania sha mos të rritet si pasojë e bashkimit;
- (iii) Aprovimi i raportit paraprak të bashkimit;
- (iv) Aprovimi i planit të biznesit;
- (v) Aprovimi i marrëveshjes paraprake të bashkimit;
- (vi) Caktimi i ekspertit të pavarur për ekzaminimin e bashkimit dhe përgatitjen e raportit të tij.

Bashkimi me përthithje do të jetë efektiv sapo të aprovohet nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në legjislacionin shqiptar. Kapitali aksionar i Bankës OTP Albania sha përfaqëson aksionet plotësisht të paguara e të nënshkruara nga aksionerët e Bankës dhe nuk do të ndryshojë si pasojë e bashkimit.

Në datën 30 qershor 2022, kapitali aksionar ishte 6,740,900 mijë Lek, si më poshtë:

Aksionar	Numri i aksioneve	Vlera (mijë Lekë)	%
OTP NYRT	67,409	6,740,900	100
Total	67,409	6,740,900	100

Në zbatim të nenit 220 të ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe bazuar në vendimin nr. 14, datë 11.3.2009 për miratimin e rregullore "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", neni 4, pika b, bashkimi me përthithje do të kryhet nëpërmjet transferimit të totalit të aktiveve dhe të pasiveve të bankës së përthithur te banka tjetër ekzistuese, e quajtur banka përthithëse. Me rastin e bashkimit me përthithje, banka përthithëse vazhdon të ushtrojë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat ajo është licencuar.

Banka Alpha Albania sha do të transferojë nëpërmjet bashkimit me përthithje tërësisht të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj dhe ekzistenca më vete e Bankës Alpha Albania sha do të përfundojë.

OTP Bank Albania Sha do të jetë shoqëria përthithëse dhe do të vazhdojë të operojë nën emrin e saj "OTP Bank" sha.

4. Politikat bazë kontabël

a. Bazat e përgatitjes

Bazuar në Raportin e Audituesit të Pavarur në lidhje me Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta më 30 qershor 2022, Pasqyrat janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit Financiar" ("MRF") e miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në përputhje të Nenit 47 të Ligjit mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë me nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, përveç investimeve në letra me vlerë, të cilat maten në vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së drejtë.

Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt.

b. Qëllimi i përgatitjes së pasqyrat financiare për qëllime të veçanta

Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur si pjesë e dokumentacionit për bashkimin me përthithje me kërkesë të Bankës së Shqipërisë në përputhje me rregulloren "Për Licencimin e Veprimtarisë së Bankave dhe Degëve të Bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë" nr. 14, dt. 11.03.2009, neni 20, pika 2.c.

c. Metoda kontabël e përdorur për bashkimin

Efektive në datën e mbylljes, OTP Albania sha do të jetë pasardhësja, nëpërmjet bashkimit me përthithje, e Alpha Bank Albania sha në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat Alpha Bank Albania është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen. Rrjedhimisht, të gjitha aktivet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivet materiale dhe jomateriale, të gjitha tepricat kreditore, si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet e tjera juridike dhe pozicione juridike të cfarëdo lloji, të arkëtueshmet dhe detyrimet, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara të Alpha Bank Albania, do të transferohen tek OTP Albania (“Aktivet dhe Detyrimet e Transferuara”).

Aktivet dhe Detyrimet e Transferuara do të përfshijnë në veçanti, por nuk do të kufizohen, si në vijim:

- (i) Çdo dhe të gjitha aktivet dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, aktive materiale dhe jomateriale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do ti përkasin Alpha Bank Albania;
- (ii) Të gjitha markat tregtare, modelet e dizajnit, patentat, njohuritë, ekspertizën dhe të drejtat e tjera intelektuale të Alpha Bank Albania;
- (iii) Licenca, koncesione, autorizime dhe të drejta të ngjashme të Alpha Bank Albania;
- (iv) Bazën e klientëve të Alpha Bank Albania;
- (v) Çdo kontratë qiraje, sigurimi, furnizimi shitje, konsultimi, kontrata shërbimi dhe kontratat në të cilat Alpha Bank Albania është palë, qoftë të lidhura tashmë ose që janë aktualisht në proces negocimi;
- (vi) Çdo kredi, borxh, depozitë të çdo lloji të krijuar nga Alpha Bank Albania;
- (vii) Çdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen me ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura ndaj Alpha Bank Albania;
- (viii) Çdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt çdo Autoriteti ku Alpha Bank Albania është palë;
- (ix) Çdo dhe të gjitha detyrimet që i atribuohen Alpha Bank Albania, duke përfshirë detyrimet potenciale dhe detyrimet e ardhshme të Alpha Bank Albania të cilat kanë ndodhur tashmë.

Nëse pëlqimi i një kreditori ose i një pale të tretë është i nevojshëm për transferimin e aktiveve të caktuara, Alpha Bank Albania (ABA) dhe OTP Albania (otp) do të përpiqen, ta sigurojnë atë.

Efektet e bashkimit për punonjësit e Bankës Alpha Albania sh.a. do të bazohen në nenet 138, 139 dhe 139/1 të Kodit të Punës. Në datën e mbylljes, të gjitha kontratat e punës ku ABA është pjesëmarrëse si palë, do t'i transferohen OTP, e cila do të vazhdojë kontratat e punës të punonjësve të transferuar së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

OTP Albania do të marrë në zotërim të gjitha librat, korrespondencat, të dhëna operative dhe të dhëna të tjera të biznesit që ruan dhe mban Alpha Bank Albania. OTP Albania gjithashtu do të marrë në zotërim çdo dhe të gjitha instrumentet dhe dokumentet e nevojshme për të paraqitur të drejtat që janë transferuar asaj. OTP Albania do të ruajë librat, korrespondencat, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit të Alpha Bank Albania përgjatë periudhës ligjore të ruajtjes.

Në bazë të trajtimit që ka ndjekur Banka në transferimin e aktiveve dhe detyrimeve dhe bazuar në raportin e audituesit të pavarur të datës 17 gusht 2022, Banka synon të transferojë të gjitha aktivet dhe detyrimet në kapital në një llogari specifike “Rezervë nga bashkimi”.

Si më poshtë janë paraqitur vlerat më 30 qershor 2022 për bankën Alpha Albania sha:

Arka dhe para në Bankën Qëndrore	9,324,892
Kredi dhe paradhënie institucioneve të kreditit	10,600,102
Investim në letra me vlerë të vendosjes	17,070,957
Investime në letra me vlerë të mbajtur deri në maturim	1,750,685
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	31,180,272
Aktivitet afatgjata materiale, neto	162,596
Aktivitet afatgjata jomateriale, neto	209,716
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	386,116
Parapagim i tatimit mbi fitimin	12,556
Aktive të tjera	602,268
TOTAL I AKTIVEVE	71,300,160
Kredi dhe paradhënie nga institucionet e kreditit	41,349
Detyrime ndaj klientëve	62,937,327
Detyrime të tjera	424,451
Provizion statistikor	405,370
TOTALI I DETYRIMEVE	63,808,497
TOTALI I AKTIVEVE NETO TË IDENTIFIKUESHMET	7,491,663

Vlera e aktiveve neto të identifikueshme prej 7,491,663 mijë Lekë të raportuara nga Alpha Bank Albania njihet në pasqyrat financiare të kombinuara për qëllime të veçanta si rezerva e bashkimit në kapitalin aksionar.

5. Informacioni financiar

Bazuar në Raportin e Audituesit të Pavarur, pasqyra financiare për qëllime të veçanta e datës 30 qershor 2022 paraqitet si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit e pozicionit financiar për qëllime të veçanta të datës 30 qershor 2022

(Në mijë lekë)	Banka ALPHA		Të kombinuara
	OTP Bank	BANK	
Arka dhe para në Bankën Qendrore	11,688,273	9,324,892	21,013,165
Kredi dhe paradhënie institucioneve të kreditit	8,291,132	10,600,102	18,891,234
Investim në letra me vlerë të vendosjes	21,285,586	17,070,957	38,356,543
Investime në letra me vlerë të mbajtur deri në maturim	-	1,750,685	1,750,685
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	75,971,502	31,180,272	107,151,774
Aktivitet afatgjata materiale, neto	584,539	162,596	747,135
Aktivitet afatgjata jomateriale, neto	213,139	209,716	422,855
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	115,903	386,116	502,019
Parapagim i tatimit mbi fitimin	-	12,556	12,556
Aktive të tjera	332,166	602,268	934,434
TOTALI I AKTIVEVE	118,482,240	71,300,160	189,782,400
Kredi dhe paradhënie nga institucionet e kreditit	19,582,631	41,349	19,623,980
Detyrime ndaj klientëve	84,506,058	62,937,327	147,443,385
Tatim fitimi i pagueshëm	160,714	-	160,714
Detyrime të tjera	787,876	424,451	1,212,327
Provizion statistikor	812,149	405,370	1,217,519
TOTALI I DETYRIMEVE	105,849,428	63,808,497	169,657,925
Kapitali aksionar	6,740,900	10,960,120	6,740,900
Primi i aksioneve	1,750	-	1,750
Rezerva ligjore dhe rregullatore	1,293,423	817,483	1,293,423
Rezerva e rivlerësimit	-	(1,362,375)	-
Rezerva të bashkimit	-	-	7,491,663
Fitimet/(Humbjet) e akumuluar	4,596,739	(2,923,565)	4,596,739
TOTALI I KAPITALIT	12,632,812	7,491,663	20,124,475
TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	118,482,240	71,300,160	189,782,400

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për qëllime të veçanta për periudhën e mbyllur më 30 qershor 2022

Kapitali i regjistruar i OTP Bank Sha nuk do të zmadhohet pas bashkimit dhe ky bashkim nuk do të përfshijë dispozita mbi raportin e këmbimit të aksioneve, shumën e çdo pagese në mjete monetare cash ose kushtet e ndarjes së aksioneve në shoqërinë përthithëse. Gjendjet e kapitalit dhe elementëve të tjerë të kapitaleve të veta të Bankës OTP Albania Sha më 30 qershor 2022 raportohen si më poshtë:

	Kapital i paguar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore	Fitimi i akumuluar	Rezerva e bashkimit	Totali
Gjendja më 30 qershor 2022 (OBA)	6,740,900	1,750	1,293,423	4,596,739	-	12,632,812
Efekti i bashkimit me përthithje	-	-	-	-	7,491,663	7,491,663
Gjendja 30 qershor 2022 pas bashkimit (OBA)	6,740,900	1,750	1,293,423	4,596,739	7,491,663	20,124,475

Të gjitha transaksionet e kryera nga banka e përthithur që nga data 30 qershor 2022 deri në momentin e miratimit nga Banka e Shqipërisë ("BSH") do të regjistrohen si transaksione të shoqërisë së përthithur dhe konsolidimi i bilancit për veprimet e kryera pas datës 30 qershor 2022 do të bëhet në përfundimin e procesit të bashkimit. Proçesi i bashkimit do të ndodhë pas marrjes së **aprovimit të bashkimit nga BSH**, moment në të cilin do të hartohet edhe bilanci i çeljes. Ndryshimet në bilancin individual të bankës pjesë e bashkimit që prej datës 30.06.2022 e deri në datën e aprovimit nga BSH do të reflektohen në bilancin e çeljes së bankës së bashkuar.